REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 15/23
Datum 10.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. nr. 15/23

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 9 i "Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave", si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE "NTSH BESI" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit " Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te ASK-së" me numër të prokurimit 124000-22-9932-2-2-1 , iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Agjencia e Statistikave të Kosovës , Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 10.01.2023, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e jashtafatshme , ankesa e OE "NTSH BESI" Prishtinë, e datës 06.01.2023 (protokoll 15/2023) ,lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te ASK-së" me numër të prokurimit 124000-22-9932-2-2-1, iniciuar nga AK Agjencia e Statistikave të Kosovës.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Agjencia e Statistikave të Kosovës që të vazhdoj më tutje, me aktivitetin e prokurimit: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te ASK-së" me numër të prokurimit 124000-22-9932-2-2-1 , iniciuar nga AK Agjencia e Statistikave të Kosovës, përkitazi me ketë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale

Autoriteti Kontraktues- Agjencia e Statistikave të Kosovës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te ASK-së" me numër të prokurimit 124-2205-2-2-1 dhe numër të brendshëm: 124 22 015 221 , iniciuar nga AK Agjencia e Statistikave të Kosovës, me datën 12.12.2022 ka publikuar B-58 - Njoftimin për anulim me Letër Standarde.

Në sistemin e prokurimit figuron që OE ankues kërkesën për rishqyrtim e ka dorëzuar me datën 15.12.2022 .

AK me datën 23.12.2022 merr vendim me te cilin e refuzon kërkesën e OE ankues të datës 15.12.2022

OE i pa kënaqur me vendimin e lartcekur me datën 06.01.2023 parashtron ankesë në OSHP (protokoll 15/2023).

-Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vlerësohet se duke pas parasysh faktin se AK ka publikuar vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim me datën : 23.12.2022, afati ligjor për ankesë për OE ankues në Organi Shqyrtues të Prokurimit ka filluar të rrjedhë nga data 24.12.2022, duke filluar nga ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe ky afat ligjor ka përfunduar me datën 04.01.2023 në ora 16:00 (marr parasysh ditët e vikendit dhe pushimet për shkak te festave zyrtare te fund vitit).

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE ankues ankesën me numër të protokollit 583/2022, e ka parashtruar në kundërshtim me neni 109 të LPP-së sepse neni 109 i LPP-së specifikon:

Afatet për Dorëzimin e Ankesës

1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu edhe neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstatoj se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE NTSH "BESI" Prishtinë, e datës 06.01.2023 (protokoll 15/2023) për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te ASK-së" me numër të prokurimit 124000-22-9932-2-2-1, iniciuar nga AK Agjencia e Statistikave të Kosovës, hedhet si e jashtafatshme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart e njëjta ankesë nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Vendimi për tarifën e sigurimit të ankesës u mor në pajtim me paragrafin 4 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP

Vjosa Gradinaj Mexhuani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

1x1 OE NTSH "BESI" Prishtinë,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së